

Gramsh, inspektime në kishën e Shën Kollit / FOTO



Sezoni turistik ka nisur por specialistët e objekteve të kultit vijojnë të përkujdesen për këto vende të cilat janë itinerare turistike mjaft të vizituara që ndërthurin kultin, kulturën dhe bukuritë natyrore.

Specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës inspektuan kishën e Shën Kollit, Grabovë e Sipërme, Gramsh. Synimi kryesor ishte evidentimi i problematikave për të vazhduar më tej me hartimin e projektit të restaurimit.

Kisha e Shën Kollit është ndërtuar rreth shekullit XVIII. Si shumë kisha orthodokse është me orientim lindje-perëndim. Hyrja kryesore është nga jugu. Përmasat janë afërsisht 25x20m.

Muratūra është prej guri të zonës dhe çatia është e mbuluar me rasa guri, sikurse

dhe banesat tipike të zonës. Përbërja e kishës është me një nef kryesor, një nef të jashtëm në anën jugore, dhe një narteks në anën perëndimore.

Në brendësi të kishës ka veshje druri, të pikturuara në nivelin e tavanit. Mbi portën hyrëse kryesore është një afresk origjinal i kishës me sipërfaqe rreth 1mX2m.









- [ATSH](#)